REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr. 520/22
Data/Datum 18.10.22
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEWË BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Ilir Halili *Ekspert shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit* *11.10.2022*	*Data e dorëzimit të raportit* *18.10.2022*	*Nr. i lëndës:* *520/22*

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 06.10.2022, OE ankues "**Sodex**", ka parashtruar ankesë me nr.**520/22**, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Furnizim me uniforma operacionale**", me nr.të prokurimit: **214-21-9106-1-1-1**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Policia e Kosovës (PK).

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë e hapur, kontratë për punë, vlera e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës: **637,000.00 €€.**

Data e njoftimit për kontratë 15.11.2021, afati i fundit për dorëzim të tenderit 25.01.2022, vendimi i AK-së 27.09.2022, kërkesa për rishqyrtim 28.09.2022, vendimi i AK-se në kërkesën për rishqyrtim 04.10.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 56 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 62 i LPP-së
Neni 44.5 i RRUOPP-së.
Vendimi i OSHP-së nr.217-224/22, i dt.12.08.2022.

Të nderuar, ne me datën 04.10.2022 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është anuluar ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk është asnjë ofertë e përgjegjshme, ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetimin se:

OE i plotesoon le gjilha krilerel e dosjes se tenderil dhe njoliiinit per konlrale niirëpo për arlikulhn nr.l Kemisha ku dlienc çminiin per njësi i cili ëslitë shume me i larle nie çmimin real ie Iregul. Medalen 31/08/2022 keini kërkuar sqaiimeshlese përdy arlikuj. Për ailikullin nr I Kemisha per çininie le larle se çmimel reale le tregul/vleres se parashikuar për arlikull si dhe per arlikulim nr 2 panlolla përçmim qëëshlë mëlëulet seçmimel realc lë tregul/vlerës se parashikuarperarlikiill. Me daten 02/09/2022 kenii pranuar përgjigje nga Operatori Ekonomik dhe ne pergjigjen e tij nuk kadëshmuarsesi ka ardhur deri ie Ibrmulimi i çmimeve pasi qe ka shtjelluai veiem disa eleiuume qe përfsliihen ne çmimin përfundimlare duke mos na ofruar dëshmi për artikuji e këikuar pëi sqarime shlese. Sipas kësaj OE cliniinohel për shkak se ka oferiuar me çmim abnounalishte ie Imte dhe çmim abnomialishle te ulei ne krahasim me alo te tregul vleres se parashikuar pei anikull. Prandaj, duke u bazuar ne Rregullnt dhe Udliëzuesin Oporativ për Prokurim Publik, tek <u>4. Administrimi i pereiithshem i proceduave te prokurimlti</u> nçni 4.2 pikne) - Te sigurohet qe çmimi i kontraktuar nuk ëslite me i larte se çmimi i tregut.; Çmimi i ofruar nga OE kane diferencë te madhe me çmimet e tregut.

Ju sqarojmë se arsyeja e AK-së për eliminimin tonë është e pa bazuar për arsyet si në vijim:

Fillimisht, AK-ja në njoftimin mbi vendimin të dt. 25.02.2022, na ka shpallur si tenderues të pasuksesshëm. Pas rishqyrtimit që ka bërë, përsëri e ka trajtuar ofertën tonë si të përgjegjshme për faktin se na ka kërkuar vërtetimet e ATK-së dhe të Gjykatës me dt.02.06.2022 dhe ne i kemi ofruar këto vërtetime me dt.02.06.2022.

AK-ja me vendimin e tanishëm po bie në kundërshtim me vendimet e saj të mëhersheme, pasi që një herë na ka shpallur të pasuksesshëm, pastaj pas rishqyrtimit na janë kërkuar vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë, pastaj jemi eliminuar, ndërsa tani pas vendimit të OSHP-së nr.217-224/22 të dt. 12.08.2022, ku paneli shqyrtues ka konstatuar se ne jemi OE i përgjegjshëm, AK-ja përsëri duke mos e respektuar vendimin e lartcekur të OSHP-së, na ka eliminuar. Si ka mundësi që në njoftimin mbi vendimin e dt. 25.02.2022 kemi qenë të përgjegjshëm dhe jemi shpallur si OE i pasuksesshëm, ndërsa tani po eliminohemi edhe pse çmimet me të cilat kemi ofertuar janë të njëjtat?!

AK-ja pas vendimit të OSHP-së nr.217-224/22, të dt. 12.08.2022, pergjate rivleresimit, na ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me çmimet për njësi për artikujt nr.l dhe nr.2, ndërsa ne u kemi kthyer përgjigjen duke ju sqaruar se oferta jonë është e ndërtuar dhe bazuar në kërkesat e AK-së, sipas dosjes

së tenderit dhe aneksit 1 dhe rrjedhimisht ju kemi konfirmuar se të gjitha çmimet janë çmime të tregut të bazuara në kërkesat e aneksit 1.

Edhe pse ne ju kemi ofruar sqarimet e kërkuara, AK-ja përsëri në njoftimin mbi vendimin e tyre na ka eliminuar me arsyetimin e njëjtë sikurse në njoftimin mbi vendimin e kaluar.

Ju sqarojmë se në lidhje me arsyen e eliminimit, ne kishim parashtruar ankesë tek ju në OSHP dhe paneli shqyrtues i OSEIP-së në vendimin nr.217-224/22 të dt. 12.08.2022, kishte konstatuar se ankesa jonë aprovohet si e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në rivlerësim. Në vendimin e lartcekur askund nuk është cekur se duhet të kërkohen sqarime shtesë, mirëpo është cekur decidivisht se:

Ne bazë të këtyre faktevc dhe arsyeve për eliminim të potencuara nga AK "Policia e Kosovës", oferta e OE ankues "Sodex" nuk nnmd të klasi fikohet si e papërgjegjshme dhe të eliminohet nga autoriteti kontraktues mbi bazën e këlyre pretendimeve.
PS'H vlërson se Autoriteti Kontraktues vendimin për anulim të këtij aktivitetit lë prokurimit e ka bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, nenil 44.8 te RRUOPP.." Procedura e prokurimil pas marrjes së ofertave nnmd të anulohet për arsyen e mëposhtme: (i) te gjithë tenderët e pergjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e AK..".

Pra në vendimin e lartcekur është specifikuar shumë qartë se oferta jonë nuk mund të klasifikohet si e papërgjegjshme, mirëpo AK-ja me njoftimin mbi vendimin e dt.27.09.2022 duke na eliminuar neve si OE të përgjegjshëm, nuk e ka respektuar vendimin e lartcekur të panelit shqyrtues të OSHP-së edhe pse vendimet e panelit shqyrtues janë përfundimtare. Ky veprim nga AK-ja tregon edhe një herë diskriminimin që po i bëjnë kompanisë tonë si OE të përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

AK-ja tani në njoftimin mbi vendimin e dt.27.09.2022 për eliminimin tonë janë thirrur në dispozitat e nenit 4 të RRUOPP-së, duke potencuar si në vijim:
anikull. Prandaj, dukc u bazuar ne Rregullnt dho Udhezuesin Operativ per Prokurim Publik, tek 4, Administrinii i penditlishem i procedurnve te prokuriniiti neni 4.2 pikn ,çl - Të slgurohet qe çmiml i kontraktuar nuk eslitë me I lartc se çmimi i tregut.; Çmimi i ofruar nga OE kane diferencë te madhe me çmimet e tregut.

Nga arsyetimi AK-së, kuptohet qartë se i janë referuar gabimisht dispozitës së lartcekur dhe njëkohësisht me këtë referim të tyre, e njëjta po bie në kundërshtim me arsyen e eliminimit tonë. Në dispozitën e lartcekur është specifikuar shumë qartë se AK-ja duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Përderisa AK-ja ka përcaktuar vlerën e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit, normalisht duke u bazuar në çmimet e tregut dhe ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar është shumë i qartë fakti se referimi i AK-së në dispozitën e lartcekur nuk qëndron, sepse vlera e parashikuar nga e njëjta është bazuar në çmime të tregut dhe oferta jonë është dorëzuar brenda vlerës së parashikuar.

AK-ja po ashtu është dashur të ketë parasysh edhe qëllimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe rëndësinë e këtyre uniformave për policinë e Kosovës, të cilat janë të domosdoshme dhe shumë të rëndësishme që ti kenë në dispozicion sidomos në këtë situatë në të cilën gjendemi ne si Shtet.
Vlen të theksohet se, vlera e parashikuar e këtij aktiviteti të prokurimit është 637 500,00€, ndërsa ne

kemi ofertuar me çmim total në vlerë prej 573, 600.00 €.
Ky fakt tregon se ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar dhe natyrisht që është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate.
Vlera e parashikuar e kontratës dihet që bëhet nga ana e autoritetit kontraktues dhe zyrtarëve kompetente për këto produkte, prandaj përderisa njësia kërkuese së bashku me zyrën e prokurimit e kanë vendosur vlerën e parashikuar 637,500.00€ atëherë ne nuk është dashur të eliminohemi në asnjë mënyrë nga ky aktivitet i prokurimit sepse kemi ofertuar brenda kësaj vlere të parashikuar.

Në nenin 13.1 të RRUOPP-së parashihet si në vijim: *"Vlera eparashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritetpara inicimit tëprocedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar nga aspekti i efikasitetit, efektivitetit të kostos, dhe përdorimit transparent dhe të drejtë të fondeve dhe resurseve publike".*

Se pretendimi ynë i lartcekur është i qëndrueshëm dhe arsyeja e AK-së e pa bazuar, këtë fakt e ka vërtetuar edhe vendimi i lartcekur i panelit shqyrtues të OSHP-së, ku është specifikuar se:
Paneli Shqyrtues sqaron se nësc analizohet përshkrimi ne DT të cilin e ka paraqitur autori kontraktues tek platforma e e-prokurimit për këtë aktivitet, shohim se për të gjitha pozicionei një sasi të njëjtë indikative për të cilat parashihet të behet furnizimi, dhe kjo lenë të kuptohe furnizimi i të gjitha pozicioneve do lë bëhel si SET (komplet) i të gjithë artikujve.

Tutje :Në dosjen e tenderit lë publikuar nga ana e A.K. "Policia e Kosovës", nuk parashihet lë vëndoset eniimi apo vlera e produktëve por vetëm njësia dhe sasia shih tabelen me poshtë:

N	Përshkrinii	NJËSIA	SASIA
1	Pantollona	copë	750
2	Kemisha	copë	750
3	Jaknc	copë	750
4	Kapela	copë	750

Pra paneli shqyrtues e ka theksuar shumë qartë faktin se AK-ja nuk ka përcaktuar vlerën e parashikuar të produkteve.

Ne me dt. 04.10.2022 nga AK-ja kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, në të cilin vendim janë dhënë arsyet e njëjta sikurse në njoftimin mbi vendimin e AK-së dhe më këtë veprim të AK-së po dëshmohet edhe një herë diskriminimi që po a bëhet neve si OE i përgjegjshëm.

Në lidhje me arsyetimin e AK-së se kinse ne kemi ofertuar me çmime abnormalisht të ulëta dhe abnormalishttë larta, ju sqarojmë se AK-ja përsëri nuk është thirrur në ndonjë dispozitë ligjore konkrete që vërteton një fakt të tillë në lidhje me këtë konstatim, ashtu siç e kishte cekur edhe paneli shqyrtues në vendimin e tyre me nr.217-224/22 të dt. 12.08.2022.

sa i përket çmirnit të ofruar per këmishë se është shumë më i lartë se çmimi real i tregut dhe se oferta e OE duhel të eliminohet këtë vlerësim nuk e mbështet në asnjë fakt apo dispozitë iigjore, kjo ngase vlera totale e ofertës së OE ankucs është më e ulët se sa vlera të cilën e ka parashikuar vetë aulorileli kontraktues. Sipas dispozitave për prokurim publik, konkretisht nenin

AK-ja përsëri edhe në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim e ka cekur dispozitën e nenit

4 të RRUOPP-së, mirëpo që e njëjta i është referuar gabimisht dispozitës së lartcekur dhe njëkohësisht me këtë referim të tyre, po bie në kundërshtim me arsyen e eliminimit tonë. Në dispozitën e lartcekur është specifikuar shumë qartë se AK-ja duhet të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Përderisa AK-ja ka përcaktuar vlerën e parashikuar për këtë aktivitet të prokurimit, normalisht duke u bazuar në çmimet e tregut dhe ne kemi ofertuar brenda vlerës së parashikuar është shumë i qartë fakti se referimi i AK- së në dispozitën e lartcekur nuk qëndron, sepse vlera e parashikuar nga e njëjta është bazuar në çmime të tregut dhe oferta jonë është dorëzuar brenda vlerës së parashikuar.

Sa i përket referimit të AK-së në nenin 38.2 të LPP-së, ju sqarojmë se AK-ja ka bërë vetëm përshkrim se çka përcakton dispozita e lartcekur dhe kjo dispozitë nuk ka të bëj fare me çmimet e ofertuara, çmimet e tregut dhe me vlerën e parashikuar, mirëpo AK-ja duke mos qenë në gjendje që të argumentojë arsyen c eliminimit thirret në dispozita të tjera jo relevante për të mbuluar arsyen e eliminimit.

Gjithashtu edhe një herë po e sqarojmë se kjo çështje është çështjc e gjykuar nga paneli shqyrtues i OSHP-së, andaj AK-ja nuk e ka respektuar vendimin e panelit shqyrtues edhe pse janë të obliguar qc të bëjnë një gjë të tillë.

Neni 6.6 i RreguIIores për procedurat e dhënies dhe revokimit të certifikatës profesionale për prokurimin publik, NR.2/2017 i dt.18.12.2017 e parasheh që mosrespektimi i vendimeve të OSHP-së përbën shkelje të rëndë ligjore.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura ne ju sqarojmë se në asnjë dispozitë ligjore nuk parashihet që një OE mund të eliminohet me një arsyetim të tillë, siç c ka dhënë AK-ja. Përderisa ne si OE i përgjegjshëm i plotësojmë të gjitha kërkcsat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht çmimi me të cilin kemi ofertuar është brenda vlerës së parashikuar të kontratës, atëherë është shumë i qartë fakti se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe arsyeja e AK-së për eliminimin dhe refuzimin e kërkesës tonë për rishqyrtim nuk qëndron dhe e njëjta nuk është e bazuar në ndonjë dispozitë konkrete ligjore.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton sc ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet e lartcekura, rezulton se AK-ja e ka anuluar pa bazë këtë aktivitet të prokurimit dhe në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë. Në këtë tender, ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe është dashur të shpallemi fitues të kësaj kontrate.

Gjithashtu ky anulim i këtij aktivitet të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 44.5 të Rregullave dhe Udhëzucsit Operativ për Prokurim Publik (RRUOPP).

Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimcve publike si dhe të gjitha fondeve dhc burimeve të tjera të autoriteteve kontraktucse në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE Sodex Group SH.P.K.

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në

RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

Qëllimi i Kontratës	**2.1**	Qëllimi i kontratës është që te përcaktohen kushtet që rregullojne dërgesat e mallrave te shënuara me poshte: **FURNIZIM ME UNIFORMA OPERACIONALE Vazhdim Afati Furnizim Uniforma Operacionale, Referoju Dosjes se Tenderit**
Vlera e parashikuar	**2.6**	**637 500,00€**

Nr	Përshkrimi	NJËSIA	SASIA
1	Pantollona	copë	750
2	Kemisha	copë	750
3	Jakne	copë	750
4	Kapela	copë	750

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES (VENDIMI PER RISHQYRTIM)

Përgjigjja ne pretendimet ankimore te OE - Sodex Group Sh.p.k.

AK nuk ka bërë shkelje te neneve të lartë perënduara pasi gjatë ri-vlerësimit janë respektuar të gjitha dispozitat e LPP-se, në vijim japim sqarime të detajuara:

Pretendimet se AK ka shkelur nenin 1 te LPP-se, nuk qëndron pasi qe AK, ne harmoni te plote me Qëllimi i këtij ligji është qe të siguroj qe ne mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejt^ të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera

të autoriteti kontraktuese ne ketë rast PK-se duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtatqë do të respektohen dhe detyrimetqë do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tiila parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësishtë procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji sqaron se në mënyre me te drejt dhe efikase ka shfrytëzuar fondet publike, duke publikuar njoftimin për kontrate me procedure te hapur duke mos diskriminuar ose favorizuar asnjë OE, për këtë aktivitet te prokurimi t ku Sodex Group Sh.p.k. - Prishtinë ne ofertën e dorëzuar për artikullin nr 1. ka çmim shume te larte 300 Euro për njësi ne krahasim me çmimin e tregut/vlerën e parashikuar 190 Euro dhe AK ka luajtur rol te plote ne harmoni me nenin 1 Qëllimi e LPP-se ka siguruarne mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Pretendimet se AK nuk ka ber shkelje te nenit 7 te LPP se Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi LPP-se sipas qëllimit ka zhviliuar procedurë te hapur për aktivitetin e prokurimit me te vetmin qellim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe i ka trajtuar te gjithë OE sipas neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Pretendimet për shkelje te nenit 44.5 RRUOPP-se Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme :

ii) asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm, andaj ky nen është zbatuar për përpikeni te plote nga AK- Polica e Kosovës.

Pretendimet për shkelje te nenit 56 te LPP-se nuk qëndron pasi secili aktivitet i prokurimit ne fazën e inicimit përbehet nga një apo ma shumë artikuj dhe vlera e secilit artikull planifikohet dhe mbi bazën e çmimeve për secilin artikull dhe sasitë arrihet edhe viera totale e planifikuar për një aktivitet te prokurimit, mbi ketë baze pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Pretendimet për shkelje te nenit 59- LPP-se janë plotësisht te pabazuara për faktin se gjitha Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve ofertat janë vlerësuar ekzaminuar dhe krahasuar ne përputhje te plot me nenin 59 me qe raste pas verifikimit te gjitha ofertave ka rezultuar se asnjë ofertë nuk ka qen e përgjegjshme sipas kërkesave ne dosjen e tenderit AK me datën 31/08/2022 kemi kërkuar sqarime shtese për dy artikuj. Për artikullin nr.1 Këmisha për çmime te larte se çmimet reale të tregut/vlerës se parashikuar për artikull si dhe për artikulim nr 2 pantolla për çmim që është më të ulet se çmimet reale të tregut/vlerës se parashikuar për artikull.

Me datën 02/09/2022 kemi pranuar përgjigje nga Operatori Ekonomik dhe ne përgjigjen e tij nuk ka dëshmuar se si ka ardhur deri te formulimi i çmimeve pasi qe ka shtjelluar vetëm disa elemente qe përfshihen ne çmimin përfundimtare duke mos na ofruar dëshmi për artikujt e kërkuar në sqarime shtese.

SODEX GROUP

Prishtinë, 02.09.2022

Palë: REPUBLIKA E KOSOVËS
Adresa e AK: I LIRA HARAMINAJ, P.N., 10000 PRISHTINË
Titulli i tenderit: Furnizimi me Uniforma Operacionale
Nr. i Referencës: 214-21-9106-1-1-1

PERGJIGJE NE KERKESEN PER SQARIME SHTESE

Bazuar ne kerkesen tuaj per sqarime shtese, me lejoni qe t'ju sqarojme si me vijon:

Sikurse per pozicionin nr. 1 te listes se cmimeve, ashtu edhe per pozicionin 2, 3, 4 dhe 5 te listes se cmimeve, ju sqarojme se oferta eshte e pregatitur duke i llogaritur dhe perfshire:

1. Cmimin e ofertuar nga Prodhuesi OFPRO
2. Transportin e mallrave nga Siloveniа per ne Kosove
3. Te gjitha taksat doganore te paraparа me ligjet e RKS-se gjate importimit te mallrave
4. Shpenzimet e dogandimeve, terminaleve dhe/ose Cargos
5. Tatimin mbi vleren e shtuar te paraparе me ligjet e RKS-se
6. Fitimin e kompanise, dhe
7. Tatimin ne fitim te paraparе me ligjet e RKS-se

Tutje sqarojme se oferta eshte e ofertuar dhe bazuar ne kerkesat e AK se sipas DT-se dhe Anekseve 1, dhe njeqindshi konfirmojnie se te gjitha emrimet jane zyrtare te tregut te bazuara ne kerkesat e Aneksit 1.

Gjithashtu sqarojme se oferta jone eshte 11% brakoetin e parapare nga AK te publikuar ne e-Platforme, ndaj me 10% nga brakoetin e parapare, perkundër faktit qe ju keni pasqyruar se emrimi eshte jashte tregut/eshte se paraqitur per artikull. Ne cdo llap rast kerkesa e AK ka nje sasi te njejte prej 750 copë per secilin artikull ne ne pozicion te se AK kerkon sot te perbere nga keta 5 artikuj sipas listes se cmimeve dhe kompania jone ju sqaron se qendron prapa ofertes se dorezuar ne tender.

Deshirojme te ju vejme ne dijeni se pyetjet e paraqitura nga ju lidhur artikullin per te cilin tani keshtu sqarime shtesë jane shoqëruar gjate seances per shqyrtim kryesor prane Organit Kompetent per Shqyrtimin e Prokurimeve Publike, Panelit Shqyrtues i te cilës ka vleresuar se AK veprimin per analiza e aktivitetit te prokurimit, duke shfaqur se per artikullin nr. 1 Komisia kemi dhenë emrimin njësi i cili eshte shumë me i larte me emrimin real te tregut, e ka bere ne konformitet me nenin 62 te LPP-se, nenit 44.8 te RrAOPP

Andaj, konsiderojme se nes keto pyetjet e paraqitura nga ju OSHP ka mujesi nje vendim te cilin ju lusim me mirekuptimin qe t'i referohemi.

Luan Avdiu

SODEX GROUP
Prishtinë

SODEX GROUP LLC
Str. Rr. Ibrahim Rugova 30 - Qyrteku
10000 - Prishtinë, Republic of Kosova
Republika e Kosovës
www.sodex.xk.com

SODEX GROUP LLC
NRT: 810755633
TVSH: 070170
FWSH: 330556459

Sipas kësaj OE eliminohet për shkak se ka ofertuar me çmim abnormalishte te larte *(dhe mbi ketë baze rezulton se jti për artikullin ttumër 1 (ttjë) - Këmishe keni dhen ofertë shumënië të larte se çtninti real i tregut përkatësisht tttbi* 60% »ie *shtrenjtëse vlera reale* e tregut dhe oferta iuaja është refttzuar ttër cmitn abnormalisht te lartë)

e tregut dhe oferta juaja është refuzuar për çmim abnormalisht te lartë).

1	Kemisha	copë	250	300,00	225,000,00	UNIFORMA d.o.o. BIH - SLOVENI - BU

si dhe çmim abnormalishte te ulet ne krahasim me ato te tregut/ vlerës se parashikuar për artikull.

1	Pantollona	copë	250	164,80	123,600,00	UNIFORMA d.o.o. BIH - SLOVENI - BU

Prandaj, duke u bazuar ne Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurim Publik, tek 4. Administrimi i përgjithshëm i procedurave te prokurimit; neni 4.2 pika c) - Të sigurohet qe çmimi i kontraktuar nuk është me i larte se çmimi i tregut.; Çmimi i ofruar nga OE kane diferencë te madhe me çmimet e tregut.

Ne lidhje me pretendim se nuk është tejkaluar vlera e përgjithshme e planifikuar për aktivitetin e prokurimit ju informoje se aktiviteti i prokurimit nuk është anuluar për tejkalim te vlerës se planifikuar por për shkak te mungesë se OE te përgjegjshëm pasi qe çmimi qe ju keni ofertuar për pozicionin 1 (një) - Këmishe është shume i larte përkatësisht mbi 60' me shtrenjtë se vlera reale e tregut si dhe çmim abnormalishte te ulet ne krahasim me ato te tregut/vlerës se parashikuar për artikull.

Ky aktiviteti është Kontrate Publike Komizë Rrjedhimisht, paragrafi 2 i nenit 38 të LPP- së e OBLIGON AK-në që fillimisht në Dosjen e Tenderit dhe në kontratën publike kornizë të përcaktojë kufijtë e blerjes plus/minus tridhjetë për qind (+/-30%) të sasive totale indikative ose vlerës totale indikative dhe për pozicion/artikull dhe kjo Kontrate Publilie Kornizë nuk e obligon AK qe te bej porosi SET siç e keni potencuar ju ne ankesën tuaj. Kjo Kontrate Publike Komizë ka gjithsej 4 pozicione te cilat kanë vlere te planifikuar çmim për njësi dhe AK mund te furnizoje për secilin pozicion ne vete. E gjithë kjo ne harmoni te plote me Neni 56.10 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP).

Pretendimet për shkelje te Neni 60 te LPP-se Kriteret për Dhënien e Kontratës është zbatuar ne përpikeni te plot pasi qe asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm.

Në lidhje me shkelje të nenit62 te LPP-se nuk qëndron fakti pasi AK në përputhje të plotë me nenin 62 ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi nuk kemi pasur asnjë ofertë të përgjegjshme.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

Vendimi i OSHP-së nr.217-224/22, i dt.12.08.2022.

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas aneksës 520/22 ka të bëjë me arsyen e elimiimit të OE ankues, ku sipas AK-së OE ka ofruar cmime jo normalisht të larta për pozicionin për këmisha, në të njëjtën kohë AK po ashtu pretenon se OE ka ofruar cmim jo normalisht të ulët për pozicionin për pantollona.

Sa i përket pretendimi të AK-së për cmime jo normalisht të larta, mendimi ekspertit është se ky pretendim ankimorë është trajtuar paraprakisht nga OSHP përmes ankesës 224/22 dhe vendimit të OSHP-së nr.217-224/22.

Sipas dispozitave ligjore në fuqi të LPP-së, në procedurë të hapur, përveq rasteve të tejkalimit të buxhetit/vlerës së parashikuar nga AK, ky ligj nuk parasheh cmime "jo normalisht të larta".

Në rastin konkret cmimi i ofertës së OE ankues është rreth 10% më i ulët se vlera e parashikuar nga vet AK.

Provë : Vlera e parashikuar nga AK-Policia e Kosovës (pika 3 e këtij raporti)

Provë : Cmimi i ofertës së OE ankues

Vlentë të theksohet se gjatë analizimit të shkresave të lëndës, nuk kemi gjetur ndonjë dëshmi se AK ka bërë parashikimin e vlerës për pozicione konkrete, siq pretendon AK se për këmisha ka qenë vlera e parashikuar prej 190€.

Vlera e parashikuar e vetme që kemi gjetur në shkresat e lëndës ka qenë **637 500,00€,** ndërsa oferta e OE ankues është me cmim dukshëm më të ulët se kjo vlerë, konkretisht cmimi i ofrruar nga OE ankues është **573,600.00€.**

Mendimi ekspertit shqyrtues është se cmimi i ofruar nga OE ankues në krahasim me vlerën e parashikuar nga vet AK-Policia e Kosovës nuk paraqet asnjë pengesë për realizimin e kontratës në pajtim me sasitë indikative të parcaktuara nga AK në dosje të tenderit.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar dhe se vendimi i AK-së për anulim është bërë në kundërshtim me vendimin e OSHP-së nr.217-224/22 dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së.

Vlenë të theksohet se neni 4 i RRUOPP-së të cilit i referohet AK në arsyetim të anulimit të aktivitetit, nuk e rregullon qështjen përfundimit/ndërprejrjes së një aktiviteti të prokurimit pas hapjes dhe vlerësimit të ofertave. Dispozitat ligjore që rregullojn qështjen e përfundimit/ndërprejrjes të një aktiviteti që rezulton me mos dhënien e kontratës ndonjë OE është neni 62 i LPP dhe neni 44.6 dhe 44.7 të RRUOPP-së, siq cekëm më lart, mendimi ekspertit është se nuk janë plotësuar asnjë nga kushtet e parapara me nenin 62 të LPP-së apo 44 të RRUOPP-së për përfundimin/ndërprejrjen e këtij aktivieti.

Sa i përket arsyetimit të AK-së se OE ankues ka ofruar cmim jo normalisht të ulët për pozicionin 2 për pantollona, ku OE ka ofruar cmimin 164.80€, sqarojmë se pas analizimit të mëtutjeshëm, kemi gjetur se produkti/pantollonat e ofruar nga OE ankues sipas të dhënave në katalog quhen "Striker ULT Combat Pants" nga prodhuesi Slloven "UF Pro".

Pas hulumtimeve të mëtutjeshme në internet, kemi gjetur se ky produkt mund të gjendet me cmim të ulët deri 192.74€.

Provë : çmimet në dyqane online për pantollona Striker ULT Combat Pants nga prodhuesi UF Pro

Dallimi mes cmimit të ofruar nga OE ankues dhe cmimieve që kemi gjetur në treg është më pak se 15%.
Me gjthëse çmimi i OE ankues për këtë produkt është më i ulët se cmimi që kemi gjetur në dyqane online, nuk mund të themi se është çmimi "jo normalisht" i ulët.
Mendimi ekspertit është se gjatë krahasimit të cmimeve dhe analizës së cmimeve të tregut, duhet të kemi parasyshë se cmimet online janë cmime të dyqaneve që bëjnë shitje me pakicë, ku blerës janë individët privat, ndërsa është e ditur që në treg të lirë, fuqia blerëse/sasia më e madhe në mënyrë direkte ka ndikim në përcaktimin e cmimit më të ulët të furnizimit.
Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart mendimi i ekspertit shqyrtues është se çmimi i ofruar nga OE ankues për pzicionin nr.2-pantollona nuk është çmim "jo normalisht" i ulët në krahasim me çmimin e tregut.

Krejt në fund mendimi i ekspertit shqyrtues është se anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 44.6 dhe 44.7 të RRUOPP-së.

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që të anulohet vendimi i AK-së dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës
- Panelit Shqyrtues - OSHP
- OE ankues – Sodex

Provë : çmimet në dyqane online për pantollona Striker ULT Combat Pants nga prodhuesi UF Pro

varuste.net/et/p114629/uf-pro-striker-ult-combat-pants

Wide selection | Kiire saatmine – ülemaailmne | Professionaalne klienditeenindus

VARUSTE.net

Otsi üle 100 000 toote hulgast. ... SPORDIALAD T

Tooted teenistujale » Riided » Püksid » Tactical Pants »

UF PRO Striker ULT Combat pants



Hind

192.74 EUR € + tarne kulud

Hinnas sisaldub käibemaks 0%

Kogus

1 tk

Värv

Brown Grey

Multicam

Suurus

(vali)

Provë : çmimet në dyqane online për pantollona Striker ULT Combat Pants nga prodhuesi UF Pro

metsastyskeskus.fi/et/p114629/uf-pro-striker-ult-combat-pants

METSÄSTYSKESKUS
PARHAAT VARUSTEET METSÄSTÄJÄLLE

Otsi üle 100 000 toote hulgast ...

JAHIPIDAMINE TOOTE

Tooted teenistujale » Riided » Püksid » Tactical Pants »

UF PRO STRIKER ULT COMBAT PANTS



Hind

192.74 EUR €

Kogus

1 tk

Värv

Brown Grey



Multicam

Suurus

(vali)